



UNITED NATIONS  
INDUSTRIAL DEVELOPMENT ORGANIZATION



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

State Secretariat for Economic Affairs SECO



# UDHËZUES PËR EKSPORTIN E BIMËVE AROMATIKE DHE MJEKËSORE SHQIPTARE





1

## UDHËZUES PËR EKSPORTIN E BIMËVE AROMATIKE DHE MJEKËSORE SHQIPTARE

Hapat kryesorë, rregulloret e BE-së  
dhe tregjet kryesore

Bimët Aromatike dhe Mjekësore (BAM) përfaqësojnë një kategori të rëndësishme produktesh për eksport nga Shqipëria dhe përfshijnë disa nënprodukte kryesore si rrënjë, gjethe, farëra dhe vajra esenciale. Këto bimë kanë një përdorim të gjerë në industrinë farmaceutike, kozmetike dhe ushqimore, dhe ofrojnë mundësi të mëdha për fermerët dhe bizneset e vogla dhe të mesme të përfshihen në tregjet ndërkombëtare.

Ky udhëzues ofron një pamje të plotë për fermerët dhe bizneset e vogla dhe të mesme që duan të eksportojnë bimë aromatike dhe mjekësore nga Shqipëria, duke përfshirë bimë dhe produkte përfundimtare që kanë potencial të lartë në tregjet ndërkombëtare.

## 1. Bimët Aromatike dhe Mjekësore kryesore për eksport

### 1.1 RRËNJËT



Shumë bimë mjekësore kanë pjesë të rrënjëve që përmbajnë komponime aktive, të cilat përdoren për prodhimin e suplementeve ushqimore dhe produkteve medicinale. Rrënjë të tilla përfshijnë:

- » Rrënja *Zingiber officinale* përdoret për të trajtuar probleme të tretjes dhe inflamacionet.
- » Rrënja e *Valeriana officinalis* përdoret për të trajtuar ankthin dhe pagjumësinë.

### 1.2 GJETHET



Gjethet e shumë bimëve janë një burim i pasur vajrash esenciale dhe përbërësve të tjerë aktivë. Disa nga gjethet më të eksportuara janë:

- » Gjethet e *Rosmarinus officinalis* përmbajnë vaj esencial të përdorur në industrinë kozmetike dhe ushqimore.
- » Gjethet e *Salvia officinalis* kanë veti antimikrobiale dhe përdoren në prodhimin e çajit dhe suplementeve ushqimore.

### 1.3 FARËRAT



Farërat e bimëve aromatike dhe mjekësore përdoren gjerësisht në prodhimin e vajrave esenciale dhe produkteve kozmetike. Shembuj përfshijnë:

- » Farat e *Foeniculum vulgare* të përdorura për veti tretëse dhe antipasmodike.
- » Farat e *Syzygium aromaticum* të njohura për veti antibakteriale dhe përmbajnë vaj esencial.

### 1.4 VAJRAT ESENCIALE



Vajrat esenciale janë përbërës kryesorë në industrinë kozmetike, aromaterapeutike dhe farmaceutike. Shqipëria eksporton sasi të mëdha të këtyre vajrave të nxjerrë nga bimë të tilla si:

- » Vaj esencial i *Lavandula angustifolia* përdoret gjerësisht për qetësimin e stresit dhe për përdorime kozmetike.
- » Vaj esencial i rozmarinës përdoret për stimulimin e qarkullimit të gjakut dhe si një përbërës në produktet kozmetike dhe farmaceutike.

## 2. Produkte përfundimtare

### 2.1 Produkte Kozmetike

Nga bimët aromatike dhe mjekësore prodhohen kremra, locione, shampo dhe vajra për trup. Produktet kozmetike me përbërës natyralë kanë fituar popullaritet të madh në tregjet ndërkombëtare. Shembuj përfshijnë:

- » Kremrat me vaj livandoje që kanë veti qetësuese për lëkurën dhe ndihmojnë në relaksim.
- » Shampot me rozmarinë të cilat ndihmojnë në përmirësimin e qarkullimit të gjakut në skalp dhe nxisin rritjen e flokëve.

### 2.2 Suplemente ushqimore

Shumë bimë mjekësore përfshihen në prodhimin e suplementeve ushqimore që përdoren për të përmirësuar shëndetin e përgjithshëm, të tilla si:

- » Suplemente me sherbelë: të cilat ndihmojnë në përmirësimin e tretjes dhe zvogëlimin e inflamacionit.
- » Suplemente me fenel: që përdoren për të përmirësuar tretjen dhe për të lehtësuar simptomat e fryrjes.

### 2.3 Produkte medicinale bimore

Këto përfshijnë çajra medicinalë dhe ekstrakte që përdoren për të trajtuar sëmundje të ndryshme, si p.sh. çajra bimore kundër inflamacionit ose infeksioneve. Shembuj të produkteve medicinale përfshijnë:

- » Çaj me sherbelë që përdoret për të lehtësuar problemet e frymëmarrjes dhe inflamacionin.
- » Ekstrakte bimore të livandos që përdoren për të ndihmuar në qetësimin dhe reduktimin e stresit.



### 3. RREGULLORET E BASHKIMIT EVROPIAN PËR EKSPORTIN E BIMËVE MJEKËSORE DHE AROMATIKE

Në Bashkimin Evropian, bimët aromatike dhe mjekësore janë të rregulluara nga një sërë ligjesh dhe direktivash që varen nga përdorimi i tyre përfundimtar. Këto produkte klasifikohen në disa kategori bazuar në destinacionin e tyre specifik, dhe eksportuesit duhet të jenë të njohur me kërkesat për secilën kategori për të siguruar përputhshmëri me standardet e BE-së. Më poshtë janë tri kategoritë kryesore të bimëve aromatike mjekësore për eksport në BE:

#### 3.1 Kozmetikë

Bimët që përdoren për prodhimin e produkteve kozmetike duhet të përmbushin kërkesat specifike të përcaktuara nga Rregullorja (EC) Nr. 1223/2009 e BE-së mbi produktet kozmetike. Sipas kësaj rregulloreje, kozmetikët përkufizohen si substanca ose përzierje që aplikohen në trupin e njeriut me qëllim pastrimi, aromatizimi, mbrojtjeje, ose përmirësimi të pamjes së jashtme.

Kërkesat kryesore për bimët që përdoren në kozmetikë përfshijnë:

- ➔ **Siguria e produktit** - Produktet kozmetike duhet të jenë të sigurta për përdorim, duke përfshirë testimin për alergjenë dhe kontaminantë të mundshëm.
- ➔ **Përgjegjësia ligjore** - Prodhuesit ose eksportuesit duhet të emërojnë një “person përgjegjës” që garanton përputhshmërinë me rregulloret dhe që mund të ofrojë të gjitha dokumentet e nevojshme për autoritetet.
- ➔ **Etiketimi dhe përbërësit** - Të gjitha produktet kozmetike duhet të kenë etiketa që përfshijnë përbërësit, funksionin e produktit, masat e kujdesit dhe informacionin mbi datën e skadencës.

#### 3.2 Suplemente Ushqimore

Bimët që përdoren për prodhimin e suplementeve ushqimore janë të rregulluara nga Direktiva 2002/46/EC e BE-së mbi suplementet ushqimore. Suplementet ushqimore përkufizohen si produkte ushqimore që synojnë të plotësojnë dietën normale dhe që përmbajnë përbërës të tillë si vitamina, minerale, dhe ekstrakte bimore.

Kërkesat për suplementet ushqimore përfshijnë:

- ➔ **Siguria ushqimore** - Suplementet ushqimore duhet të jenë të sigurta për përdoruesit dhe të testohen për prezencën e ndotësve dhe mbetjeve kimike, si pesticide apo metale të rënda.
- ➔ **Kërkesat për shëndetin** - Ndalohet përdorimi i pretendimeve shëndetësore të paprovuara, dhe suplementet duhet të përmbushin standardet e përcaktuara për sigurinë ushqimore në BE.
- ➔ **Etiketimi** - Produktet duhet të jenë të etiketuar në mënyrë të qartë, duke përfshirë përmbajtjen ushqimore, masat e rekomanduara ditore, dhe paralajmërimet për përdoruesit e ndjeshëm.

#### 3.3 Produkte Medicinale Bimore

Bimët që përdoren për qëllime medicinale rregullohen nga Direktiva 2004/24/EC mbi produktet tradicionale medicinale bimore dhe Direktiva 2001/83/EC mbi produktet medicinale për përdorim njerëzor. Sipas këtyre rregullave, çdo produkt që ka për qëllim trajtimin ose parandalimin e sëmundjeve duhet të regjistrohet si produkt medicinal.

Për këtë kategori, kërkesat përfshijnë:

- ➔ **Regjistrimi dhe licencimi** - Produktet medicinale bimore duhet të regjistrohen dhe licencohen para se të hyjnë në tregun e BE-së. Ky proces përfshin paraqitjen e provave të sigurisë dhe efikasitetit të produktit.
- ➔ **Provat për përdorim tradicional** - Produktet që janë të bazuara në përdorime tradicionale mund të përfitojnë nga regjistrimi i thjeshtuar për produkte tradicionale medicinale bimore, duke dëshmuar përdorimin e tyre të sigurt për të paktën 30 vjet (15 prej të cilëve brenda BE-së).
- ➔ **GMP dhe standardet e cilësisë** - Produktet medicinale bimore duhet të prodhohen sipas Praktikave të Mira të Prodhimit (GMP) dhe të përmbushin standardet e cilësisë të përcaktuara nga Farmakopeja Evropiane.



## 4. HAPAT KRYESORË PËR EKSPORTIN E BIMËVE MJEKËSORE DHE AROMATIKE

Eksporti i suksesshëm i bimëve aromatike dhe mjekësore në Bashkimin Evropian kërkon përgatitje të kujdesshme dhe përbushjen e disa kërkesave të detajuara. Më poshtë janë hapat kryesorë që duhet të ndiqni për të garantuar përputhshmëri me standardet dhe kërkesat e BE:

### 4.1 Përshkrimi i produktit

Për të eksportuar bimë aromatike dhe mjekësore, është e rëndësishme që produkti të përshkruhet me detaje, për të përbushur standardet ndërkombëtare dhe kërkesat e tregut të BE-së.

#### Përshkrimi duhet të përfshijë:

- » **Emri shkencor i bimës** - Sigurimi i emrit të saktë botanik të bimës (gjini, specie, dhe autoriteti shkencor).
- » **Pjesa e përdorur e bimës** - Përshkruani pjesën e bimës që do të përdoret (rrënjë, gjethe, farëra, lule, etj.).
- » **Metodat e përpunimit** - Përcaktoni mënyrën e mbledhjes dhe përpunimit të bimës, duke përfshirë tharjen, nxjerrjen e vajrave esenciale, distilimin ose çdo metodë tjetër të përpunimit.

### 4.2 Tarifat dhe Klasifikimet

Përdorimi i saktë i nomenklaturës së përbashkët të BE-së (Combined Nomenclature - CN) është thelbësor për identifikimin e tarifave dhe klasifikimin e produkteve. Kjo përfshin përdorimin e kodit të tarifave CN për të kategorizuar produktin tuaj siç duhet.

#### Për shembull:

Për vajra esenciale, përdorni nënkodin CN për të identifikuar tarifën doganore dhe masat e importit që ndikojnë në çmimin dhe konkurrencën e produktit në tregun evropian.

### 4.3 Standardet e Cilësisë

Për të siguruar që produkti të përbushë standardet ndërkombëtare të cilësisë, eksportuesit duhet të zbatojnë Praktikën e Mira Bujqësore dhe të Përpunimit (Good Agricultural and Collection Practices - GACP).

#### Kjo përfshin:

- » Bimët aromatike dhe mjekësore duhet të jenë të lira nga mbetjet e pesticideve që tejkalojnë normat e lejuara nga BE-ja.
- » Sigurohuni që produktet tuaja të përbushin kufijtë e lejuar për metalet e rënda (si plumbi, mercuri, dhe kadmiumi).
- » Kontrolloni për kontaminim të mundshëm nga patogjenë si baktere ose mykotoksina, që mund të ndikojnë në sigurinë e produktit.

### 4.4 Etiketimi dhe Paketimi

Etiketimi dhe paketimi duhet të jenë në përputhje të plotë me rregullat e BE-së për produktet kozmetike, suplemente ushqimore dhe produkte medicinale.

#### Etiketat duhet të përfshijnë:

- » Të gjithë përbërësit aktivë dhe ndihmës që përbëjnë produktin.
- » Të shprehur në njësi metrike, për shembull në gram ose mililitra.
- » Vendosja e origjinës së saktë të produktit, si “Prodhuar në Shqipëri”.
- » Tregoni afatin e përdorimit për të siguruar që produkti është i sigurt dhe efektiv brenda një periudhe të caktuar kohe.

### 4.5 Certifikatat e nevojshme

Për eksportimin e bimëve mjekësore dhe aromatike në BE, certifikatat janë thelbësore për të vërtetuar përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare.

#### Këto përfshijnë:

- » **Certifikata Global G.A.P:** E rëndësishme për produktet që dëshmojnë përputhjen me praktikën e mira bujqësore.
- » **Certifikata organike:** Bimët e prodhuara organikisht duhet të kenë certifikatë organike të njohura nga BE-ja për të hyrë në tregjet evropiane.
- » **Certifikata GMP (Praktikë e Mira të Prodimit):** Kjo është e nevojshme për produktet medicinale bimore për të siguruar që prodhimi dhe përpunimi i tyre janë kryer sipas standardeve të cilësisë së kërkuara.

### 4.6 Certifikatat dhe Standardet e Qëndrueshmërisë

Sigurimi i përputhshmërisë me standardet e qëndrueshmërisë jo vetëm që ndihmon në mbrojtjen e mjedisit, por gjithashtu rrit besueshmërinë dhe konkurrueshmërinë e produktit në tregjet ndërkombëtare.

#### Disa nga certifikatat kryesore të qëndrueshmërisë përfshijnë:

- » **Certifikata FairWild:** Kjo certifikatë ndihmon në mbrojtjen e biodiversitetit dhe siguron që bimët e egra të mblihen dhe tregtohen në mënyrë të qëndrueshme.
- » **Certifikata organike:** Produktet që përbushin rregullat e BE-së për prodhimin organik janë gjithnjë e më shumë të kërkuara në tregjet evropiane.
- » **Certifikata GMP:** Siguron që produktet medicinale bimore janë prodhuar dhe përpunuar sipas standardeve të përcaktuara të cilësisë, duke garantuar sigurinë dhe efektivitetin e tyre.

Duke ndjekur këto hapa dhe duke siguruar përputhshmëri me kërkesat e BE-së, fermerët dhe bizneset e vogla dhe të mesme në Shqipëri mund të maksimizojnë potencialin e eksportit të bimëve aromatike dhe mjekësore, duke hyrë në tregjet ndërkombëtare me produkte cilësore dhe të qëndrueshme.

## 5. TREGJET KRYESORE TË EKSPORTIT PËR BIMËT AROMATIKE DHE MJEKËSORE

Eksporti i bimëve aromatike dhe mjekësore nga Shqipëria është një sektor në rritje, me tregje të ndryshme ndërkombëtare që kërkojnë produkte të këtij lloji për shkak të përfitimeve të tyre medicinale, kozmetike dhe ushqimore. Tregjet kryesore të eksportit përfshijnë disa nga ekonomitë më të mëdha globale, të cilat vendosin standarde të larta për cilësinë dhe qëndrueshmërinë e produkteve. Më poshtë janë përshkrimet e katër tregjeve kryesore për eksportet e bimëve mjekësore dhe aromatike:

### 5.1 Shtetet e Bashkuara

Shtetet e Bashkuara janë një nga tregjet më të mëdha për bimët aromatike dhe mjekësore, me kërkesë në rritje për produkte natyrale, suplemente ushqimore dhe përbërës kozmetikë. Ky treg kërkon që produktet të jenë në përputhje me rregullat e **Food and Drug Administration (FDA)** dhe kërkesat për **Good Manufacturing Practices (GMP)** për produktet medicinale dhe suplemente ushqimore. Kërkesa për cilësi të lartë dhe përputhshmëri me standardet e sigurisë ushqimore dhe farmaceutike është thelbësore për hyrjen në tregun amerikan. Gjithashtu, **Certifikatat Organike USDA** janë të rëndësishme për produktet organike.

### 5.2 Gjermania

Gjermania është tregu më i madh në Evropë për bimët aromatike dhe mjekësore dhe ka një fokus të fortë në produktet natyrale dhe organike. Gjermania ka një traditë të gjatë në përdorimin e bimëve mjekësore dhe është një nga importuesit kryesorë të këtyre produkteve në BE. Certifikatat e cilësisë si **EU Organic** dhe **FairWild** janë të nevojshme për të siguruar që produktet përmbushin standardet e kërkuara për qëndrueshmëri dhe mbrojtjen e biodiversitetit. Gjermania gjithashtu kërkon përputhshmëri me **Farmakopeja Evropiane**, duke vendosur standarde strikte për cilësinë dhe sigurinë e produkteve.

### 5.3 Japonia

Japonia është një treg që kërkon produkte të cilësisë së lartë dhe i kushton shumë vëmendje sigurisë dhe pastërtisë së bimëve aromatike dhe mjekësore. Japonia ka kërkesa strikte për produktet medicinale dhe suplementet ushqimore, me rregullore të detajuara për cilësinë, etiketimin dhe përmbajtjen e mbetjeve të pesticideve. **Certifikatat Organike JAS (Japanese Agricultural Standards)** janë thelbësore për produktet që synojnë tregun organik japonez. Për më tepër, Japonia ka një kërkesë të lartë për vajra esencialë dhe përbërës kozmetikë natyralë.

### 5.4 Kina

Kina është një treg në rritje për bimët aromatike dhe mjekësore, veçanërisht për produktet që përdoren në **Medicinën Tradicionale Kineze (TCM)**. Kërkesa për përbërës natyralë dhe produkte bimë është në rritje për shkak të preferencës për trajtime natyrale dhe produkte që ndihmojnë në mirëqenien e përgjithshme. Produktet që eksportohen në Kinë duhet të përmbushin rregulloret e **China Food and Drug Administration (CFDA)**, dhe gjithashtu, **Certifikatat Organike dhe të Qëndrueshmërisë** janë të rëndësishme për hyrjen në tregun kinez. Për më tepër, Kina është një treg ku standardet e qëndrueshmërisë, si FairWild, janë gjithnjë e më shumë të kërkuara për produktet e egra.

**Eksportuesit e bimëve aromatike dhe mjekësore** që synojnë këto tregje ndërkombëtare duhet të sigurohen që produktet e tyre të përmbushin standardet e larta të cilësisë, sigurisë dhe qëndrueshmërisë. Certifikatat si GlobalGAP, Organike dhe GMP janë kritike për suksesin në këto tregje. Përputhshmëria me rregullat dhe direktivat ndërkombëtare siguron që produktet shqiptare të jenë konkurruese dhe të pranojnë kërkesat e konsumatorëve globalë.





**GLOBAL QUALITY  
AND STANDARDS PROGRAMME**

## **NJË INICIATIVË GLOBALE**

GQSP ndihmon prodhuesit e vegjël për të përmirësuar cilësinë e produkteve të tyre, të përbushin standardet ndërkombëtare dhe të eksportojnë nëpër botë



**UNITED NATIONS  
INDUSTRIAL DEVELOPMENT ORGANIZATION**



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

**Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike SECO**